Marrëveshje Pune

Ndërmjet

Akademisë së Kosovës për Siguri Publike
(AKSP)

Dhe

Agjencisë së Bashkimit Evropian për Trajnim të Zbatimit të Ligjit (CEPOL)

MARRËVESHJE PUNE NDËRMJET AKADEMISË SË KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE DHE AGJENCISË SË BASHKIMIT EVROPIAN PËR TRAJNIM TË ZBATIMIT TË LIGJIT

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (në tekstin e mëtejmë referuar si "AKSP"), dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për Trajnim të Zbatimit të Ligjit (në tekstin e mëtejmë referuar si "CEPOL"),

Duke qenë të vetëdijshëm për interesin e përbashkët për të rritur efektivitetin e zbatimit të ligjit në luftën kundër krimit, veçanërisht krimit ndër-kufitar, në Evropë duke mbajtur trajnime të përbashkëta për zyrtarët e zbatimit të ligjit për të ngritur vetëdijen dhe për të rritur njohurinë e instrumentëve dhe mekanizmave të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe evropian, si dhe të një game të gjërë të lëmive të veçanta, si kundër-terrorizmi, trafikimi me narkotikë dhe krimi i organizuar, migrimi ilegal, dhe kontrolli kufitar ose trafikimi me qenie njerëzore;

Duke pasur parasysh Rregulloren (BE) 2015/2219 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 nëntorit 2015 për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Trajnimin e Zbatimit të Ligjit (CEPOL) dhe duke e zëvendësuar dhe shfuqizuar Vendimin e Këshillit 2005/681/JHA (në tekstin e mëtejmë referuar si "Rregullorja"),;

Duke pasur parasysh Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës*, nënshkruar në Strasburg më 27 tetor 2015 që ka hyrë në fuqi më 1 prill 2016;

Duke pasur parasysh rolin dhe mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian të Zbatimit të Ligjit në Kosovë (EULEX),

Duke pasur parasysh Vendimin e Bordit Udhëheqës të CEPOL më 9 gusht 2014 për të autorizuar Drejtorin e CEPOL-it për të negociuar një Marrëveshje Pune me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;

Duke pasur parasysh Nenin 36 të Rregullores e cila tregon se CEPOL, siç është themeluar nga kjo Rregullore, do të jetë pasardhësi ligjor sa i përket të gjitha kontratave të përfunduara nga, detyrimeve që mbështeten në, dhe pronave të fituara nga CEPOL siç janë themeluar nga Vendimi 2005/681/JHA;

Duke pasur parasysh Vendimin e Bordit Menaxhues të CEPOL 12/2016/MB;

* Ky shënim është pa paragjykim të qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.

Pa paragjykuar zhvillimet e ardhshme në fushën përkatëse të politikave që mund të rezultojnë nga rishikimi i instrumentëve kornizë ekzistues ligjorë, të bashkëpunimit dhe politikë ose traktateve të reja të ardhshme;

Janë pajtuar si në vijim:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes dhe autoriteti kompetent

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje Pune është definimi i marrëdhënieve ndërmjet AKSP-së dhe CEPOL-it, duke specifikuar, në veçanti, natyrën, shtrirjen dhe mënyrën në të cilën AKSP mund të merr pjesë në punën e CEPOL-it, dhe krijimi i aranzhimeve (marrëveshjeve) të nevojshme për të ndihmuar bashkëpunimin reciprok. Shkëmbimi ose shpërndarja e të Dhënave të Ndjeshme të Zbatimit të Ligjit, përfshirë të Dhënat Personale, nuk është brenda fushëveprimtarisë së kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjërës nga dispozitat e saj.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi siç është themeluar në këtë Marrëveshje do të:

a) lejojë pjesëmarrjen e zyrtarëve të zbatimit të ligjit të Kosovës në sesionet trajnuese të CEPOL, dhe të zyrtarëve të zbatimit të ligjit të BE-së që operojnë në fushën e Çështjeve të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme në sesionet trajnuese të organizuara nga AKSP;

b) definojë aktivitetet e mundshme përkrahëse të AKSP-së në organizimin e kurseve trajnuese të CEPOL;

c) harmonizojë më tutje standardet e trajnimit të zbatimit të ligjit sa i përket bashkëpunimit ndër-kufitar;

d) ngrisë shkëmbimin e praktikave më të mira dhe japë AKSP-së qasje në seksionet publike të rrjetit elektronik të CEPOL, të definuar si seksionet e qasshme për të gjithë përdoruesit e regjistruar të e-Net por me kufizime për përdoruesit e paregjistruar, nën kushtet e reciprocitetit dhe në masë të nevojshme për arritjen e objektivave për të cilat është arritur pajtueshmëri e përbashkët përmes Marrëveshjes së tashme të Punës.

Neni 3

Mbajtja e takimeve

Takimet e CEPOL mund të organizohen në Kosovë; shpenzimet për takime të tilla do të kompensohen nga CEPOL, sipas rregullave të tij.

Neni 4

Pjesëmarrja në kurse trajnimi

Zyrtarët e zbatimit të ligjit të Kosovës mund të marrin pjesë në kurset trajnuese të ofruara nga CEPOL.

Si rregull, shpenzimet për pjesëmarrje të të trajnuarve nga Kosova në kurset trajnuese të CEPOL do të mbulohen nga institucioni dërgues i pjesëmarrësve. Këto shpenzime do të shënohen në ftesën e aktivitetit.

Neni 5

Përkrahja për aktivitetet e trajnimit të CEPOL

Zyrtarët e Kosovës mund të kontribuojnë në kurset trajnuese të CEPOL duke përkrahur Shtetet Anëtare të BE-së për të organizuar kurse trajnimi të CEPOL; kjo mund të përfshijë ofrimin e ekspertëve për nevojat e kurseve të tilla. Zyrtarët e zbatimit të ligjit të BE-së mund të marrin pjesë edhe si palë të duhura (përshtatshme) në kurset trjanuese të organizuara nga AKSP. Çfarëdo shpenzimi i drejtpërdrejt i shkaktuar për shërbimet e ofruara nga AKSP në përkrahje të aktiviteteve trajnuese të CEPOL do të kompensohet nga CEPOL sipas rregullave të tij.

Kjo Marrëveshje Pune nuk krijon ndonjë obligim të veçantë për Palët e Treta për të marrë pjesë në sesionet ose kurset trajnuese të organizuara brenda kornizës së saj.

Neni 6

Standardet e harmonizuara të trajnimit të zbatimit të ligjit

AKSP mund të përkrah zhvillimin dhe implementimin e Kurrikulës së Përbashkët siç është përcaktuar në Nenin 4 të Rregullores dhe mund të integrojë ato në programet kombëtare të trajnimit në masë të mundshme dhe të nevojshme.

Neni 7

Shkëmbimi i praktikave më të mira, të zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe të trajnimit

AKSP dhe CEPOL do të shpërndajnë praktikat më të mira dhe të gjeturat e hulumtimit.

Do të lehtësohen shkëmbimet dhe dërgimet relevante të përkohshme të zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe/ose anëtarëve të lartë të stafit trajnues.

Do të ngritet dialogu i vazhdueshëm dhe shkëmbimi i praktikave më të mira duke i dhënë AKSP-së qasje në seksionet publike të e-Net-it të CEPOL, të definuar si seksionet e qasshme për të gjithë përdoruesit e-Net por me kufizime për përdoruesit e paregjistruar, nën kushtet e reciprocitetit dhe në masë të nevojshme për arritjen e objektivave për të cilat është arritur pajtueshmëri e përbashkët në këtë Marrëveshje Pune.

Neni 8

Pika kombëtare e kontaktit

AKSP do t'ia komunikojë CEPOL-it detajet e kontaktit të Pikës Kombëtare të emëruar të Kontaktit brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së tashme të Punës dhe në çfarëdo ngjarje para se të hyjë në fuqi. Çfarëdo ndryshimi në këtë aspekt do t'i komunikohet me shkrim Drejtorit Ekzekutiv të CEPOL-it.

Pika Kombëtare e kontaktit do të jetë përgjegjës për kryerjen e detyrave të mëposhtme:
- të kontribuojë dhe të promovojë programet e punës, kalendarët vjetorë dhe faqen e internetit të CEPOL-it në mesin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit të Kosovës;
- të organizojë dhe të koordinojë emërimet e duhura të pjesëmarrësve dhe ekspertëve për aktivitetet në nivel kombëtar në kohë dhe në mënyrë transparente;
- të lehtësojë komunikimin dhe koordinimin ndërmjet CEPOL dhe institucioneve përkatëse kombëtare;
- të koordinojë zbatimin e aktiviteteve dhe takimeve në Kosovë;
- të emërojë një koordinator për shkëmbime dhe të ofrojë mbështetje në krijimin dhe zbatimin e programeve të shkëmbimit për zyrtarët e zbatimit të ligjit;
- të emërojë një menaxher E-net dhe të promovojë përdorimin e rrjetit elektronik të CEPOL-it për trajnimin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit.

Neni 9

Lufta kundër mashtrimit

Në përputhje me Nenin 29 paragrafi 2 i Rregullores, Gjykata Evropiane e Auditorëve ka fuqi të auditimit, në bazë të dokumenteve dhe të kontrolleve në vend, mbi të gjithë përfituesit e granteve, kontraktorët dhe nënkontraktorët që kanë marrë fonde të Bashkimit nga CEPOL.

Në përputhje me Nenin 29 paragrafi 3 i Rregullores, OLAF mund të kryejë hetime, duke përfshirë edhe kontrolle dhe inspektime në vend për të shikuar nëse ka pasur mashtrim, korrupsion apo ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm që prek interesat financiare të Bashkimit në lidhje me ndonjë grant apo kontratë të dhënë nga CEPOL. Këto hetime do të kryhen në përputhje me dispozitat dhe procedurat e përcaktuara në Rregulloren (BE, Euratom) Nr 883/2013 dhe në Rregulloren e Këshillit (Euratom, KE) Nr 2185/96.

Neni 10

Amendamentimi i Marrëveshjes së Punës

AKSP ose CEPOL mund të propozojë, përmes mjeteve të shkëmbimit të korrespodencës zyrtare, që të amandamentohet kjo Marrëveshje Pune ose pjesë të saj. Amandamentet në këtë Marrëveshje Pune do të hyjnë në fuqi pasi që të jenhë kryer procedurat e brendshme përkatëse.

Neni 11

Ndërprerja e Marrëveshjes së Punës

Kjo Marrëveshje Pune mund të ndërpritet nga secila palë me njoftim (paralajmërim) të shkruar 6 muaj.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Pune do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj.

Këtë të premte më 24 mars, dymijë e shtatëmbëdhjetë, në duplikat në gjuhën angleze. **Prof. h.c. Dr. Ferenc Bánfi , Drejtor Ekzekutiv,** **Për Agjencinë e Bashkimit Evropian për Trajnim të Zbatimit të Ligjit (CEPOL)**	Këtë të premte më 24 mars, dymijë e shtatëmbëdhjetë, në duplikat në gjuhën angleze. **Z. Skender Hyseni, Ministër i Punëve të Brendshme**